



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 71/12
Prishtinë, më 26.06.2012, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Hykmete Bajrami.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Kushtrim Aliu (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Bedri Hamza, Ministër i Financave, Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Petrit Popova, Drejtor i Departamentit të Buxhetit Komunal në MF, Rejhane Zylfijaj (GIZ), Teki Shala (Ekspert), monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 6.06.2012;**
3. **Raportim nga Ministri i Financave për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2011;**
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012;**
5. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve;**
6. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur e komisionit dt. 06.06.2012

Kryetarja, konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Raportim nga Ministri i Financave për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi se ne i kemi kërkuar Ministrit të Financave të dërgojë raport me shkrim lidhur me vërejtjet e ngritura në raportin e progresit, për çka ministri ka dërguar raportin, por me që kemi paraparë edhe në planin e punës e kemi ftuar Ministrin që të raportoj për të arriturat që janë bërë në tremujorin e dytë për të adresuar sfidat që janë ngritur në raportin e progresit.

Bedri Hamza, pas çdo raporti të progresit, Ministria e Financave i analizon sfidat e adresuara dhe përgatitë planin dhe ndërmerr aktivitetet për plotësimin e këtyre sfidave dhe ato vendosen për planin e veprimtari për partneritete evropiane me rastin e freskimit vjetor të tij. Në çështjet e ngritura lidhur me buxhetin, ju njoftoj se buxheti 2012 është hartuar dhe aprovuar me harmoni me rekomandimet e FMN-së, gjatë periudhës raportuese është arritur progres në hartimin dhe nxjerrjen e dokumenteve buxhetore si vijon: lëshimi i qarkores buxhetore 01/2013, lëshimi i instruksioneve për rishikimin e buxhetit dhe përgatitjen dhe procedimin e tij për Kuvend. Është përgaditur raportin për periudhën janar-mars, për monitorimin e planit financiar të projektit fizik të projekteve kapitale. Aktivitetet e ardhshme do të koncentrohen në përgatitjen e buxhetit 2013, si pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave nga organizatat buxhetore, si dhe vlerësimet 2014-2015, organizimi i dëgjimeve buxhetore dhe qarkoreve buxhetore, konsultimet në qeveri dhe përcaktimi i kufijve final buxhetore.

Kryetarja, nga raportimi i Ministrit dhe nga raporti që është dërguar me shkrim paraprakisht, janë vërejtur të arriturat në adresimin e sfidave që janë ngritur në raportin e progresit. Këto informata që i kemi siguruar do të jenë pjesë e raportit për tremujorin e dytë, që do të dërgohet Komisionit për Integritet Evropian dhe më pas do të diskutohet në seancë plenare.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetarja, Qeveria ka proceduar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të buxhetit 2012 dhe për këtë çështje kemi ftuar Ministrin e Financave, të na jep sqarime rreth plotësimeve dhe ndryshimeve të cilat janë bërë në ligjin fillestar të buxhetit, në këtë takim që po diskutohet në parim projektligji.

Bedri Hamza, njoftoi se përveç çështjeve tjera edhe rishikimi i buxhetit është diskutuar deri në detaje me misionin e FMN-së që po qëndron në Kosovë. Në këtë dokument duke respektuar edhe Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike nuk kemi bërë lëvizje sa i përket deficitit buxhetor. Ndryshimet të cilat kanë ndodh në rishikim janë ndryshime me qëllim që organizatat buxhetore të kenë fleksibilitet për rregullimet e brendshme brenda kategorive ekonomike. Sa i përket pozicionit të pagave ka pasur lëvizje simbolike. Ka një ndryshim me buxhetin fillestar të doganat që është rreth 8 milion € shtesë, që ka ardhur si rezultat masave shtesë në pjesën e të hyrave. Një dallim tjetër është në fondet e Bankës Botërore që kanë qenë të planifikuara 30 milion euro, ndërsa tani i kemi 37 milion €, pasi që janë hequr dilemat për këto fonde dhe ato tashmë janë pjesë e buxhetit të konsoliduar. Nga marrëveshja me FMN-në kanë ardhur 5 milion € dhe priten edhe 47 milion tjera. Totali i të hyrave ka ndryshuar për 4 milion euro dhe kjo si rezultat i ndryshimit të kufirit të AKP-së si rezultat i mundësisë që i jep ligji këtij agjencioni. AKP-ja pritet të derdh në buxhetin e Kosovës 30 milion € si të hyra të dedikuara. Sa i përket shpenzimeve, kemi pasur një rritje si rezultat i rritjes së të hyrave në fondin prej bankës botërore. Rritja e buxhetit në

kategorinë e pagave dhe mëditjeve është për 3 milion euro, prej të cilave 2 milion për AKP-në, ndërsa 1 milion tjera për punësimet e reja që janë bërë për disa institucioneve të reja që janë diskutuar me FMN-në. Ndryshimet në kategorinë për mallra dhe shërbime janë simbolike dhe kanë ndodhur si rezultat i ndryshimeve edhe në nivelin komunal dhe kjo për shkak të kushteve të vështira atmosferike dimrin që e lamë pas, ku janë shkaktuar shpenzime të mëdha për komunat në kontraktimin e operatorëve për pastrimin e borës. Ndërsa kjo ka reflektuar me zvogëlimin simbolik të investimeve kapitale. Po ashtu kemi një zvogëlim të deficitit primar që ka ardhur si rezultat i ndryshimeve shtesë. Sa i përket inflacionit mbetet në parashikime fillestare sillet aty 1.2 %. Më pas Ministri njoftoi për ndryshimet që janë bërë në organizatat konkrete buxhetore. Qëllimi i rishikimit ka qenë që organizatave buxhetore ti jepet fleksibilitet me rialokime brenda kategorike ekonomike, ndërsa ndryshimet mes kategorive ekonomike janë simbolike më shumë se simbolike.

Muhamet Mustafa, theksoi se rishikimi i buxhetit është një ngjarje e rëndësishme për Kuvendin dhe deputetët duhet të marrin një informatë sa më të saktë gjithçka që ndodh në rrafshin e stabiliteti makroekonomik. Duke dëgjuar ministrin dhe duke shikuar tabelat, pyetja ime për Ministrin do të ishte se sa ka qenë i nevojshëm ky rishikim nëse kemi të bëjmë me ndryshime të simbolike dhe ndoshta këto ndryshime kanë mundur të bëhen sipas ligjit aktual që lejon transferet e brendshme deri në përqindje të caktuar nga Qeveria. Mendoj që në të ardhmen që qdo herë kur flasim për buxhetin, duhet të kemi dokument shtesë për një analizë makroekonomike të situatës financiare e cila qëndron mbrapa rishikimit të buxhetit. Duhet të jemi të informuar se qfarë po ndodh me parashikimet për rritjen ekonomike, për të cilat parashikimet e Qeverisë dallojnë prej atyre të FMN-së. Pastaj qfarë ndikimi do të ketë në të ardhurat e buxhetit, a do të realizohet plani? Po ashtu sqarime për ndryshimin në të hyrat dhe shpenzimet apo ndryshimi i madh në rritjen e rezervës bankare 400 milion euro, që së bashku me fondet e privatizimit dhe fondit Pensional po rriten mjetet e imobilizuara që paraqesin mbi 30% e GDP-së. Çështje tjerët është që dokumenti të ishte më i qartë për deputetët, kjo sqaron saktësisht se qfarë është ndryshuar dhe arsyet pse. Qëllimi është që mos të merremi vetë me atë qfarë është hequr dhe shtuar, por duhet me racionalitet të shifet se qfarë qëndron pas ndryshimeve, qfarë ndikimi do të kenë në rritjen ekonomike, në punësim sepse buxheti do të jetë në shërbim të prioritetëve ekonomike

Bedri Hamza, përkundër dallimeve në parashikimet të rritjes ekonomike, FMN është pajtuar me pse rritja ekonomike prej 3.8% do të jetë e mjaftueshme për përmbushjen e planit të të hyrave sipas projeksioneve fillestare. Sa i përket bilancit bankar ka qenë 411 milion ndërsa është 474 milion euro, ku janë përfshirë edhe 30 milion€ që janë mjetet e dedikuara nga AKP për buxhetin e Kosovës. Arsyeja kryesore pse kemi kërkuar rishikim të buxhetit për shkak të korrektësise që nivelit qendror por sidomos komunave të iu jepet fleksibilitet për rregullime të brendshme, pa ndryshuar strukturën e buxhetit.

Latif Gashi, me që jemi duke shqyrtuar në parim projektligjin, mendojë që duhet rekomanduar për miratimin e tij dhe mëpastaj të punojmë si komision edhe përmes grupeve punuese. Buxheti duket i përgaditur mirë dhe shifet se kemi rritje në krahasim me buxhetin fillestar, në këtë drejtim të buxheti qendror ka një ulje raport me buxhetin fillestar, ndërkaq buxheti i nivelit komunal është rritur për 1.38 % në raport me buxhetin fillestar. Rishikimi i buxhetit ka qenë i nevojshëm për të parë realizimin e buxhetit nga organizata buxhetore, siq është rasti i ART-së dhe nevojë për të mundësuar fleksibilitet për komunat që të bëjnë transfere të brendshme.

Sali Asllanaj, ajo që mendojë për kritik është rritja e buxhetit për paga, përkundër dakrodimit me FMN për kufijtë e caktuar për kategori dhe nga kjo shifet se nuk është respektuar disiplina fiskale. Rritja prej 3 milion euro vlerësoj se nuk është e madhe dhe ajo çka duhet thuhet është me rishikim po përpiket të legalizohet një punë që është kryer më herët, janë shtuar mjetet në paga që konsideroj se është jashtëligjshme pasi që është bërë jashtë procedurave të parlamentit. Ndryshimi të bilanci bankar ka të bëjë me parashikimet për privatizimi, gjë që dy vite nuk po del përqindja e besueshmërisë. Po ashtu mendojë

që oferta për distribucion e ofruar nga kompania turke është shumë e ulët, kjo mund të ndodh për shkak të nevojës për të mbushur buxhetin.

Bedri Hamza, nuk kemi të bëjmë me rritje të pagave, por çështja është e ndërlidhur me AKP-në që ka qenë e financuar nga donatorët, ndërsa tani me miratimin e ligjit të ri, ky agjencion financohet nga të hyrat vetanake, dhe 5% e totali të fondeve nga ky agjencion, përdoren për financimin e aktiviteteve të tij. Më pas Ministri sqaroi shumat në paga që kanë ndryshuar në institucionet përkatëse nga buxheti fillestar.

Naser Osmani, me ligjin e ri të Agjencisë Kosovare të Privatizimit kemi aprovuar një taksë që përdoret për paga por edhe për shpenzimet për procesin e likuidimit. Është meritë e kryetarit Dino Asanaj që është bërë ndryshimi i ligjit dhe si rezultat tanimë në buxhetin e Kosovës do të derdhen 30 milion euro, për të cilat mjete ka pasur kritika. Sa i përket rishikimit kjo ndodh në secilin vend. Megjithatë keni vepruar keq kur në janar i keni marrë paret për komunën e Prishtinës dhe nuk e mbështes këtë ndryshim.

Xhevdet Neziraj, do të ishte e nevojshme të ishin më të qarta ndryshimet në rezervat bankare. Mendoj se edhe ne si Komision dhe Ministria e Financave duhet të këmbëngulim në diskutimet me FMN, që rezerva të jetë sa më minimale dhe mjetet të futen në qarkullim dhe mos të kemi buxhetin e bllokuar. Sa i përket rishikimi rishikim është dashtë me u bo për shumë arsye edhe kërkesat e komunave si anëtar i komisionit Mendojë se rishikimi është dashur të bëhet, për arsye se kemi plotë kërkesa nga komunat që si rezultat i dimrit të vështirë kanë pasur shpenzime të mëdha dhe kanë nevojë për transfere të brendshme. Politika e ka vendin e vet por nuk duhet gjykuar profesionalisht që mos të sjellim vendin në situatë të palakmueshme.

Pas diskutimeve, Komisioni me Dy vota Abstenim (Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi), asnjë Kundër dhe të gjithë të tjerët Për, nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve

Latif Gashi, njoftoi se grupi punues ka harmonizuar qëndrimet për amendamentet që janë propozuar dhe dilema ka qenë tek propozimi i dedikimit të taksës ekologjike për ambientin dhe me që ky propozim nuk ishte në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike për të pasur fond të veçantë jemi pajtuar që të shtohet teksti ku thuhet se taksa ekologjike ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së ambientit.

Salih Asllanaj, theksoi se ashtu siq e sqaroi z. Gashi, ka rrjedhur puna e grupit punues dhe ideja ka qenë që mjetet që mbledhen përmes taksës ekologjike të dedikohen për ambientin. Jam përkrahës që të kemi një fond të mbledhjes së të hyrave buxhetore, por se shpërndarja duhet të bëhet për ruajtjen e ambientit. Amendamentet e propozuara nga grupi punues u miratuan njëzëri.

Pas diskutimeve, Komisioni me një votë Abstenim (Albana Fetoshi), asnjë Kundër dhe të gjithë anëtarët tjerë Për, nxori këtë

REKOMANDIM

I. Miratohen amendamentet e propozuara nga Grupi Punues i Komisionit për Buxhet dhe

- Financa për Projektligjin nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve.
- II. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në procedura të mëtutjeshme.

6 Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011

Kryetarja, theksoi se sipas kërkesës së Komisioni, ART ja ka sjellur raportin e detalizuar ku ka pasur mundësi të shikohet rrjedhja e shpenzimeve të këtij institucioni. Janë 4 pozicione që i kanë tejkaluar shpenzimet në krahasim me atë që është planifikuar. Shifet se nëse heqin shumën që është marrë me vendim të Qeverisë, buxheti është shpenzuar 54% krahasuar me atë që është planifikuar.

Latif Gashi, shifet se edhe pas shkurtimeve të buxhetit nga Qeveria, ky institucion ka shpenzuar buxhetin në nivel shumë të ulët, për çka edhe jo rastësisht e mora shembull me rastin e diskutimit për rishikimin e buxhetit.

Xhevdet Neziraj, theksoi se ky institucion lidhur me një projekt kapital ka pasur problem me procedurat e prokurimit, që është kontestuar nga OSHP. Në takimi e fundit kryetari i ART-së theksoi se e kemi fituar rastin, ndërsa OSHP kanë thënë se e kanë humbur dhe si rezultat është ky problemi në realizimin e ultë të shpenzimeve kapitale.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011.

7. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi se ka ftuar Teki Shalën në këtë takim si mundësi që të angazhohet si ekspert i jashtëm, për të analizuar buxhetin e rishikuar dhe kërkesat shtesë buxhetore që kanë ardhur dhe të përgatis një raport me informata në formë të shkruar për anëtarët e komisionit, ndoshta të jep nje arsyeshmëri rreth këtyre kërkesave, ne bazë të krahasimeve të cilat i bërë në buxhet. Propozojë që të angazhohet si ekspert për këtë fazë të rishikimit të buxhetit, i cili do të financohet nga buxheti i Komisionit dhe nga NDI.

Komisioni njëzëri përkrahu propozimin për angazhimin e Teki Shala, si ekspert të jashtëm për analizimin dhe përgatitjen e raportit lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Mbledhja përfundoi: 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj